



INSTAT

INSTITUTI I STATISTIKAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
POLICISË SË SHQIPËRISË**

Nr. 138/13 Prot

Tiranë, më 24.02.2020

Nr. 1123/3 Prot

Tiranë, më 27.02.2020

**MARRËVESHJE “PËR NDRYSHIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET INSTAT DHE DPPSH”**

Ndërmjet

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
në vijim referuar si “INSTAT”

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHQIPËRISË
në vijim referuar si “DPPSH”

Mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 10/2017 datë 09.02.2017, Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” si dhe duke patur parasysh vullnetin për bashkëpunimin e ndërsjellë, Palët bien dakord të kryejnë shtesat dhe ndryshimet në Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e Memorandumit “Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar” zëvendësohet me “Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare””.
2. Në Seksionin “Hyrje”, paragrafi 6 riformulohet si më poshtë:

REPUBLICA E SHQIPËRISË

“Në nenet 4 dhe 5, nenin 13/1 (ç), nenin 13/2 (ë), nenin 25/8, nenin 31, nenin 33 pikat 1 dhe 2, dhe nenin 40/1 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, në vijim referuar “Ligji i statistikave””

3. Në pikën 5 “Udhëzimet për standartet profesionale”, paragrafi (1) ndryshohet si më poshtë:

“(1) INSTAT detyrohet të vendosë në statistikatat zyrtare të gjitha përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat, në përputhje me konceptet dhe klasifikimet ndërkombëtare, aty ku është e mundur (Neni 14, pika 2 (e) e ligjit të statistikave).”

4. Në pikën 6 “E drejta e hyrjes dhe shkëmbimi i të dhënave”, paragrafi (7) “Nenin 15” zëvendësohet me “Nenin 31”;

5. Në pikën 7 “Sigurimi i zbatimit të përshtatshëm të programit” bëhen këto ndryshime:

a. Në paragrafin (2), fjalët “Këshillit të Statistikave” zëvendësohen me fjalën “Kuvendit”;

b. Paragrafi (3) hiqet.

c. Në fund të paragrafit (5) shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) DPPSH njofton dhe merr mendim paraprakisht nga INSTAT-i për çdo akt ligjor ose nënligjor i cili i propozohet për miratim Kuvendit ose Këshillit të Ministrave dhe që mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në aktivitetet statistikore që kryhen në Republikën e Shqipërisë.”

6. Aneksi zëvendësohet me Aneksin bashkëlidhur kësaj Marrëveshje;

7. Ndryshimet e parashikuara në këtë Marrëveshje për ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit hyjnë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve.

8. Marrëveshja “Për ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit” hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë.

PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
POLICISË SË SHTETIT

ARDI VELIU
DREJTORI PËRGJITHSHËM

Data e nënshkrimit

PËR
INSTITUTIN E STATISTIKAVE

ELSA DHULT
ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT
DREJTORES

24/02/2020
Data e nënshkrimit